



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA FIER

MIRATOI

KRYETARI BASHKISË

ARMANDO SUBASHI



PLANI I MBARËSHTIMIT

TË EKONOMISË PYJORE

« VAJKAN LIBOFSHË »

PËR PERIUDHËN 2026 – 2036



Bashkia Fier

Drejtoria e Pyjeve dhe Mjedisit

Sektori i Pyjeve

PLANI I MBARËSHTIMIT TË EKONOMISË PYJORE
“Vajkan Libofshë”


Për periudhën; 2026– 2036

Projektuesit : Ing. Roventa Sera

Ing. Ildo Trifoni

Ing. Majlinda Karaj






Harta e Njesisë së Menaxhimit (EP) "Vajkan"
BASHKIA FIER

Legend				
■ Depo uji	Hidrografia	Rrjeti rrugor	□ Kufi parcele	Izohipse
■ Qender e banuar	— përrua	— rrugë kryesore	□ Kufi nenparcele	— kryesore
⊙ Kuotat	— kanal	— rrugë dytësore	□ Kufi administrativ (Bashki)	— ndermjetese
		— rrugë lokale	□ Kufi Njese Menxhimi (EP)	


Shkalla 1:25,000



Harta e Punimeve të propozuara / Njesisë së Menaxhimit "Vajkan"
BASHKIA FIER

Legend			Punimet te propozuara	
 Depo uji	 Rrjeti rrugor	 Kufi parcele	 (i) pyllëzim	 Hapje koridoresh per mbrojtje nga zjarri
 Qender e banuar	 rruge kryesore	 Kufi nenparcele	 (i) pyllëzim (ii) ricungim lisi	
 Kuotat	 rruge dytësore	 Kufi administrativ (Bashki)	 (i)pastrim nenpylli; (ii)ricungim lisi; (iii) pyllëzim	
Hidrografia		 Kufi Njesi Menxhimi (EP)	 (i) pyllëzim (ii) shfrytëzim shkurresh	
 përrua	 rruge lokale		 (ii) pastrim nenpylli	
 kanal			 (ii) rrallim i tipit II	

Shkalla 1:25,000




Harta e Tipit të pyllit / Njesisë së Menaxhimit "Vajkan"
BASHKIA FIER

Legend

- | | | | | |
|--|---|--|--|--|
| Depo uji | Hidrografia | Rrjeti rrugor | Kufi parcele | <p>Tipi i pyllit</p> Pyje të dominuar nga Pinus pinea
 Pyje të dominuar nga Quercus pubescent
 Pyje të dominuar nga Eucalyptus |
| Qender e banuar | përrua | rrugë kryesore | Kufi nenparcele | |
| Kuotat | kanal | rrugë dytësore | Kufi administrativ (Bashki) | |
| | | rrugë lokale | Kufi Njesisë Menaxhimi (EP) | |

Shkalla 1:25,000



Harta e Rrugeve, Infrastruktues dhe Zonave te degraduara /
Njesisë së Menaxhimit "Vajkan" , BASHKIA FIER

Legend

- | | | | | | | | | | | | | | | | | |
|---|--|---|---|--|---|---|--|--|--|--|---|---|--|--|--|---|
| Depo uji | Qender e banuar | Kuotat | Hidrografia | përrua | kanal | Rrjeti rrugor | rrugë kryesore | rrugë dytësore | rrugë lokale | Kufi parcele | Kufi nenparcele | Kufi administrativ (Bashki) | Kufi Njesi Menxhimi (EP) | Izohipse | kryesore | ndermjetese |
|---|--|---|---|--|---|---|--|--|--|--|---|---|--|--|--|---|

Shkalla 1:25,000





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA FIER

M I R A T O I
KRYETARI BASHKISË
ARMANDO SUBASHI

PLANI I MBARËSHTIMIT
TË EKONOMISË PYJORE
« VAJKAN LIBOFSHË »

PËR PERIUDHËN 2026 – 2036



Bashkia Fier

Drejtoria e Pyjeve dhe Mjedisit

Spektori i Pyjeve

PLANI I MBARËSHTIMIT TË EKONOMISË PYJORE “Vajkan Libofshë”

Për periudhën; 2026– 2036

Projektuesit : Ing. Roventa Sera

Ing. Ildo Trifoni

Ing. Majlinda Karaj

PËRMBAJTJA E PLANIT TË MBARËSHTIMIT

1. HYRJE

- 1.1. Qëllimi dhe objektivat e planit të mbarështimit të pyjeve, (PMP)
- 1.2. Ecuria e punës dhe përgjegjësitë
- 1.3. Metodologjia e punës
- 1.4. Informacioni i përdorur në hartimin e PMP

2. PËRSHKRIMI I PËRGJITHSHËM I EKONOMISË PYJORE

- 2.1. Informacion i përgjithshëm rreth Ekonomisë Pyjore
- 2.2. Pronësia, administrimi, organizimi
- 2.3. Vendndodhja gjeografike dhe ndarja administrative
- 2.4. Konteksti i Bashkisë dhe Ekonomisë Pyjore
- 2.5. Historiku i Mbarështimit të Pyjeve dhe Kullotave në Ekonominë Pyjore
- 2.6. Situata demografike dhe social ekonomike
- 2.7. Marketingu i produkteve pyjore drusore dhe jo drusore
- 2.8. Gjetia dhe peshkimi
- 2.9. Fasilitetet rekreacionale dhe didaktike
- 2.10. Prania e zonave të mbrojtura, specieve dhe stacioneve

3. GJENDJA AKTUALE E PYJEVE

- 3.1. Mbarështimi dhe funksionet e Pyjeve
- 3.2. Përdorimi i territorit (aktual dhe propozimet)
- 3.3. Forma e qeverisjes (aktuale dhe propozimet)
- 3.4. Ndarja e ekonomisë pyjore në parcela dhe nënparcela

3.5. Ndarja e pyjeve

4. KUSHTET STACIONALE

4.1. Klima

4.2 Topografia dhe morfologjia

4.3. Gjeologjia

4.4. Tokat

4.5. Rrjeti hidrologjik dhe burimet e furnizimit me ujë

4.6. Erozioni në shpate dhe rrjedhjet ujore

4.7. Rrëshqitjet

5. VEGJETACIONI DHE BIODIVERSITETI

5.1. Brezat bioklimatike

5.2. Pyjet dhe kullotat

5.3. Tipet e pyjeve

5.4. Tipet e kullotave

5.5. Tipet potenciale të vegjetacionit

5.6. Biodiversiteti

5.7 Rreziqet për biodiversitetin dhe efektet mbi planifikimin

5.8. Mundësitë për aktivitetet didaktike dhe kërkim shkencor.

6. ANALIZA E PYJEVE DHE KULLOTAVE

6.1. Analiza e të dhënave për Pyjet

6.1.1. Analiza e tipeve të pyjeve

6.1.2. Shpërndarja e sipërfaqes dhe volumit sipas formës së qeverisjes.

6.1.3. Struktura e pyjeve sipas klasave të moshës dhe klasave të prodhimit

6.2. Analiza e të dhënave të kullotave

6.2.1. Gjëndja e kullotave

- 6.2.2. Madhësia e sipërfaqes së kullotave dhe vendodhja e tyre
- 6.2.3. Altituda, pjerrësia, kundrejtimi, kushtet hidrologjike
- 6.2.4. Mbrirshmëria
- 6.2.5. Grumbullimi i të dhënave për zonat e djegura në kullota(10 vitet e fundit)

7. REZULTATET E INVENTARIZIMIT TË PYJEVE DHE KULLOTAVE

- 7.1. Rezultatet e Inventarizimit të Pyjeve
 - 7.1.1. Analiza statistikore e Inventarizimit
- 7.2.2. Volumi dhe rritja në volum e grumbujve pyjor
- 7.2.3. Struktura Vertikale
- 7.2.4. Cilësia e materialit drusor
- 7.2.5. Biomasa dhe Faktorët e Ekspansionit të Biomases
- 7.2. Gjëndja shëndetsore dhe fitosanitare
 - 7.2.1. Drurët e tharë
 - 7.2.2. Dëmtimet e tjera
- 7.3. Prerjet e paligjshme
 - 7.3.1. Prerjet e paligjshme, gjendja aktuale dhe efektet ne procesin e planifikimit
 - 7.3.2. Impakti i prerjeve ilegale në planifikimin dhe mbarështimin e pyjeve
- 7.4. Rezultatet e Inventarizimit të Kullotave
 - 7.4.1. Tipi dhe cilësia e kullotave
 - 7.4.2. Përdoruesit e kullotave dhe koha
 - 7.4.3. Llojet e bagëtive
 - 7.4.4. Përdorimi aktual dhe kapaciteti mbajtës i kullotave
 - 7.4.5. Infrastruktura aktuale
 - 7.4.6. Problemet mbi kullotjen dhe furnizimin e blegtorisë me bazë ushqimore
 - 7.4.7 Volumi dhe rritja në volum e grumbujve pyjore

8. MASAT MBROJTËSE PËR PARANDALIMIN E ZJARREVE

- 8.1 Analiza e riskut nga zjarri në territorin përkatës.
- 8.2 Identifikimi dhe hartëzimi I zonave me risk të lartë zjarri.

- 8.3 Planifikimi I masave infrastrukturore për parandalimin dhe kontrollin e zjarreve.
- 8.4 Masat për menaxhimin e vegjetacionit dhe reduktimin e materialit djegës.
- 8.5 Mekanizmat e koordinimit institucional për parandalimin dhe reagimin ndaj zjarreve

9. OBJEKTIVAT E MBARËSHTIMIT TË PYJEVE DHE KULLOTAVE

- 9.1. Objektivat e përgjithshme për planifikimin afat-gjatë
- 9.2. Objektivat kombëtare për Zhvillimin e Pyjeve dhe Kullotave. Pajtuueshmëria e PMP me planifikimin rajonal dhe atë në nivel Bashkie .
- 9.3. Objektivat kryesore të PMP.
- 9.4. Objektivat specifike të ekonomisë pyjore/NJM .
- 9.5. Objektivat specifike mbi përdorimin e tokës, funksionin dhe formën e qeverisjes
 - 9.5.1. Objektivat specifike mbi tipet e pyjeve
 - 9.5.2. Objektivat specifike silvikulturale
 - 9.5.3 .Objektivat specifike për kullotat
 - 9.5.4. Objektivat specifike mbi biodiversitetin
 - 9.5.5. Objektivat specifike mbi gjëndjen shëndetsore
 - 9.5.6. Objektivat specifike mbi faunën
 - 9.5.7. Objektivat specifike për pyjet me funksion prodhues
 - 9.5.8. Objektivat specifike për pyjet me funksion konservues.

10. MASAT/AKTIVITETET E PLANIFIKUARA NË KUADËR TË MBARËSHTIMIT TË PYJEVE

- 10.1. Prerja vjetore e lejuar/mundësia vjetore e shfrytëzimit
- 10.2. Prerja vjetore silvikulturore
- 10.3. Planifikimi vjetor i masave
 - 10.3.1. Masat në Pyje
 - 10.3.2. Masat në kullota
 - 10.3.3. Masat në infrastrukturë dhe në zonat e degraduara, rekreacionale dhe didaktike
- 10.4. Masat afat-gjata
 - 10.4.1. Masat silvikulturale në trungishte

- 10.4.2. Masat silvikulturore në cungishte
- 10.4.3. Masat silvikulturore në shkurre
- 10.4.4. Gjëndja dhe masat në infrastrukturën e ekonomisë pyjore
- 10.4.5. Masat specifike për aktivitetet rekreacionale dhe didaktike

11. VLERËSIMI EKONOMIK

- 11.1. Vlerësimi i efekteve të masave të planifikuara në pyje dhe kullota
- 11.2. Planifikimi i të ardhurave/përfitimeve
- 11.3. Planifikimi i kostove/shpenzimeve
- 10.4. Analiza kosto-përfitim

- 12. LIDHJA MIDIS PLANIT TË MBARËSHTIMIT TË PYJEVE DHE SISP**
- 13. PROÇESI I VALIDIMIT TË PMP NË SISP**
- 14. MIRATIMI I PLANIT TË MBARËSHTIMIT TË PYJEVE**
- 15. MONITORIMI I ZBATIMIT TË PMP**
- 16. RISHIKIMI PERIODIK I ZBATIMIT TË PLANIT TË MBARËSHTIMIT**
- 17. RISHIKIMI AFAT-MESËM I PLANIT TË MBARËSHTIMIT**
- 18. RISHIKIMI FINAL I PLANIT TË MBARËSHTIMIT**
- 19. PËRGATITJA E HARTAVE**

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Plani i mbarështimit të ekonomisë pyjore “Vajkan Libofshë” është planifikimi afatgjatë i qeverisjes së pyjeve dhe kullotave për një periudhë maksimumi 10 vjet i cili duhet të mbulojë të gjitha aspektet sociale, ekologjike dhe ekonomike.

Ky plan mbarështimi është mbështetur në manualin e mbarështimit në fuqi dhe ka vlefshmëri përdorimi 10 vjet (2026-2036), synon që të merren në konsideratë të gjithë faktorët që lidhen direkt ose indirekt ndërmjet tyre – popullata lokale, administrimi i pyjeve, ekoturizmi, agroturizmi, interesi që ofron pylli, etj, pa harruar kufizimin e erozionit, ruajtjen e natyrës dhe stabilitetin e resurseve, plotësimi i nevojave me material drusor, si dhe përdorimi i prodhimeve të dyta pyjore nëpërmjet një zhvillimi të qëndrueshëm të pyjeve.

Mbrojtja e ekosistemeve natyrore, përmirësimi i peisazhit rural dhe mbrojtja e biodiversitetit përbën një drejtim të rëndësishëm të projektit dhe zgjerimi i këtyre zonave do të jetë në qëndër të objektivave të veçantë.

Mbështetur në termat e referencës të hartuara dhe objektivin e përgjithshëm për një menaxhim të qëndrueshëm e përdorim shumëfunksional të pyjeve po japim një përshkrim të shkurtër të vendndodhjes dhe shpërndarjes së pyjeve sipas formës së qeverisjes dhe kategorisë së përdorimit të territorit.

Ekonomia pyjore “Vajkan Libofshë” shtrihet brenda kufijve të Njësisë Administrative Libofshë dhe të Njësisë Administrative Mbrostar.

Me VKM-së 433, datë 08.06.2016 Bashkia Fier është pronare vetëm në nëngastrat dhe emërtimet popullore që janë si në tabelën e mëposhtme:

Qarku	Bashkia	Kodi kadastral	Ekonomia Pyjore/Kullosore	Ngastra nëngastra	Sip. HA	Kategoria përdorimit të territorit	Emërtesa popullore
Fier	Fier	FR27001a	Vajkan Libofshë	1a	20	Pyll	Mali Libofshës
Fier	Fier	FR27001b	Vajkan Libofshë	1b	6	Pyll	Mali Libofshës
Fier	Fier	FR27002b	Vajkan Libofshë	2b	4	Pyll	Gropa e Libofshës
Fier	Fier	FR27006a	Vajkan Libofshë	6a	34.5	Pyll	Vajkan
Fier	Fier	FR27006b	Vajkan Libofshë	6b	3.6	Bim. pyjore	Vajkan
Fier	Fier	FR27007	Vajkan Libofshë	7	19.6	Pyll	Vajkan
Fier	Fier	FR27008	Vajkan Libofshë	8	1.1	Pyll	Vajkan
		Sip. Totale			88.8		

Fondi pyjor i ekonomisë pyjore të marrë në studim është:

- pyll	85.2 ha
- sip. me bim. pyjore	3.6 ha
- sip. bujqësore	0 ha
- kullotë – livadh	0 ha
- urbane	0 ha
- ujore	0 ha
- djerr (eroduar) jo produktive	0 ha
- të tjera	0 ha
Totali	88.8 ha

Pyjet me funksion prodhues zënë 88.8 ha ose 100% të sipërfaqes pyjore.
Grumbulli pyjor i kësaj Ekonomie Pyjore qeveriset si më poshtë:

- ✓ Pyjet e lartë 24 ha ose 27 % të sipërfaqes
- ✓ Pyjet cungishte zënë 61.2 ha ose 68 % të sipërfaqes
- ✓ Shkuret mesdhetare zënë 3.6 ha ose 5 % të sipërfaqes.

Tipet e pyjeve që përbëjnë masivin pyjor të kësaj ekonomie pyjore janë:

Pyje trungishte, shkurre dhe cungishte (me volum drusor) gjithsej janë 88.8 ha me volum total 3224 m³, nga të cilët sipas formës së qeverisjes: Trungishte 24 ha dhe volum 1800 m³, Cungishte 61.2 ha me volum 1402 m³ dhe shkurre 3.6 ha me volum 22 m³.

Rritja mesatare e grumbullit është

Trungishte 1.5 m³/ha vit x 24 ha = 36 m³ vit

Cungishte 0.5 m³/vit x 61.2 ha = 30.6 m³ vit

Shkurre 0.3 m³ /vit x 3.6 ha = 1.08 m³/ vit.


- ❖ Formacione me Pishë Mesdhetare (pishë e butë dhe pishë e egër kryesisht)
- ❖ Formacione me Pyje cungishte të përfaqësuara nga dushqet .
- ❖ Formacione me Pyje shkure mesdhetare
- ❖ **Fuqia lëndore në këmbë e pyjeve është 3224 m³**
- ❖ **Vëllimi mesatar i Pyjeve të ekonomisë pyjore “ Vajkan Libofshë ” është 37 m³ për ha.**

Rritja Vjetore shkon Trungishte 1.5 m³/ha/vit x 24 ha = 36 m³/vit

Cungishte 0.9 m³/vit x 61.2 ha = 55.08 m³/vit

**Shkurre 0.3 m³ /vit x 3.6 ha = 1.08 m³/ vit për gjithë ngastrat kemi një rritje vjetore 74.08 m³ në vit.
Dhe per periudhen 10 vjeçare 748 m³.**

Detyrat kryesore për 10 vjeçarin e ardhshëm në zbatim të këtij Plani Mbarështimi rrjedhin nga programi strategjik i Qeverisë Shqiptare për zhvillimin e sektorit të pyjeve e kullotave, në harmoni të plotë me interesat dhe programet e Bashkisë Fier.



HYRJE

1.1 Qëllimi dhe objektivat e planit të mbarështimit të pyjeve , (PMP)

Qëllimi kryesor të këtij Plani Mbarështimi të Pyjeve dhe Kullotave (PMPK) është të zhvillojë mbarështim të qëndrueshëm dhe shumëfunksional të pyjeve bashkiake brenda kufijve të Ekonomisë Pyjore (EP) “Vajkan Libofshë” për periudhën 2027-2037, duke balancuar aspektet ekonomike, sociale dhe ekologjike. Në këtë drejtim, ai synon të përcaktojë përmes një qasjeje të integruar, pajtueshmërinë e ngushtë midis kufizimeve dhe mundësive për të vlerësuar burimet pyjore e kullimore dhe nevojat bashkiake si dhe palëve të interesuara lokale për të maksimizuar përfitimet e tyre.

Gjithashtu si qëllim kryesor i hartimit të këtij plani mbarështimi është dhe hartimi i një plani që të plotësojë objektivat afat-shkurtra dhe afat-gjata në përputhje me tipet e grumbujve pyjor.

Në objektivat e këtij plani mbarështimi një vend të rëndësishëm zë qëllimi primar “sigurimi i një mbarështimi të qëndrueshëm, afatgjatë dhe shumë funksional i pyllit”.

Ndërkohë që si qëllimi i ndjekur është krijimi i kushteve të përshtatshme për të rritur kapacitetin e stafit lokal dhe bashkiak për të zbatuar masat përmes një mirëkuptimi të ndërsjellë dhe duke rritur bashkërendimin dhe ndërveprimin.

Objektivat e planit të mbarështimit u hartuan në mbështetje të ligjit për zhvillimin e sektorit pyjor; ligji kuadër 57/2020 “Për pyjet” dhe akte të tjera nënligjore dhe në bashkëpunim me banorët e Njesisë Administrative dhe organet e pushtetit vendor Njesisë Administrative Vajkan dhe Mbrostar .

Objektivat kryesore janë:

- Vlerësimi i multifunksioneve të pyllit për ruajtjen e biodiversitetit dhe shtimit të të ardhurave.
- Sigurimi i normalitetit në grumbullin pyjor që të garantojë një zhvillim të qëndrueshëm dhe afatgjatë për të dhënë një prodhim maksimal duke siguruar nivel të lartë të ardhurash.
- Intensifikimi i rritjes natyrore të grumbullit duke shfrytëzuar grumbullin e tejppjekur dhe përmirësimi i strukturës së klasës së moshës.
- Shtimi i sipërfaqes së mbulesës pyjore dhe sigurimi i ripërtëritjes natyrore nëpërmjet kryerjes së punimeve për sigurimin e gjeneratës së re të pyjeve në ato pjesë të territorit ku ajo mungon ose është dëmtuar, duke rikthyer bimësinë autoktone tradicionale.
- Rritje e cilësisë së trungut dhe e kurorës së drurëve me synim përmirësimin e cilësisë së prodhimit të grumbullit.
- Përmirësimi i mëtejshëm i shërbimit me rrugë të ekonomisë nëpërmjet mbajtjes në gjendje optimale të rrjetit rrugor egzistues dhe hapjes së rrugëve auto të reja.
- Pakësimi i efekteve negative të erozioni
- Pakësimi i veprimtarive të paligjshme në territoret pyjore dhe kullimore.
- Të shfrytëzojë potencialet për mundësinë e gjuetisë dhe të grumbullimit të bimëve mjeksore e të florës spontane.

- Të krijojë mundësi për zhvillimin e turizmit dhe Agroturizmit në zonë dhe të evidentojë dhe zhvillojë pjesët e territorit me vlera të larta peisazhistike, historike, kulturore apo me vlera të veçanta tradicionale lokale.

1.2 Ecuria e punës dhe përgjegjësitë

Fillimisht është kryer puna përgatitore për sigurimin e bazës materiale, si instrumentet e ndryshëm, dokumentacionin e nevojshëm, plani i inventarizimit aktual, hartat topografike e parcelare, përgatitjen e formularëve për punimet e terrenit, etj.

Faza tjetër lidhet me punimet e terrenit, për ndërtimin e rrjetit të sipërfaqeve provë dhe marrjen e të dhënave të nevojshme.

Puna në terren ka filluar në fund të muajit Janar dhe ka vazhduar deri me 15.05.2026 .

Pas përfundimit të punimeve të terrenit, koha në vijim ka shërbyer për kryerjen e punimeve të zyrës me përpunimin e të dhënave me program kompjuterik, përgatitjen e hartave dixhitale të gjendjes dhe të punimeve, .

Pas grumbullimit të dokumenteve të nevojshme për hartimin e planit të mbarështimit, si:

- plani i vjetër i inventarizimit të vitit 1985, hartat e ekonomisë pyjore,

- dokumentet që lidhen me aspektin ligjor në fushën e pyjeve si: Ligji Nr. 57/2020, datë 30.04.2020 “Për pyjet”, i ndryshuar - Dokumenti i Politikave Pyjore në Shqipëri, 2019-2030 me VKM Nr. 814, datë 31.12.2018.

Përgatitja e planit u krye duke ndjekur operacionet si më poshtë:

- Përcaktimin e objektivave të mbarështimit.
- Rikonicionin e plotë të pjesës pyjore objekt vlerësimi me grupin e mbarështimit, përfaqësues të organeve të pushtetit lokal e të strukturës menaxhuese të pyjeve në Bashkinë Fier
- Grumbullimin e informacionit ekzistues për ngastrat si plani i inventarizimit të mëparshëm, regjistrat e kryerjes së punimeve pyjore, regjistri i zjarreve, sëmundjeve dhe dëmtuesve, regjistrat e shfrytëzimit të lëndës drusore, të dhëna të kadastrës pyjore për ndryshime të mundshme gjatë 30-40 viteve të shkuara, hartat respektive për këtë ekonomi pyjore etj.
- Kryerjen e rilevimeve silvikulturore e dendrometrike në sipërfaqet provë të përhereshme në terren si dhe me marrjen e informacionit të nevojshëm nga banorët dhe mbartjen e tyre në skedat e përshkrimit dhe inventarizimit të ngastrës, të materializuara në terren, grumbullimi i informacionit lidhur me të dhëna për tokën dhe drurët model etj.

Në vijim është vazhduar me punimet e zyrës, kompjuterizimin e të dhënave të përshkrimit parcelar si dhe të inventarizimit të sipërfaqeve provë, të përhereshme, planimetrimin e ngastrës, përgatitjen e raporteve përkatëse.

1.3 Metodologjia e punës

Metoda e punës e zbatuar për hartimin e planit të mbarështimit është mbështetur në zbatimin e motivuar të manualit të ri të mbarështimit të pyjeve dhe kullotave (2018), ku përshkruhen qartë udhëzimet për përshkrimin parcellar, udhëzimet për inventarizimin me sipërfaqe prove si dhe udhëzimet për punimet e zyrës. Ky udhëzues është zbatuar me disiplinë e korrektësi të lartë teknike në të gjitha fazat e punës.

Gjithashtu është zbatuar një metodologji në përputhje të plotë me përshkrimet në Udhëzuesin e Planeve të mbarështimit të pyjeve dhe kullotave të vitit 2019. Në fakt është thelbësore që të lidhet analiza e burimeve pyjore dhe kullosore me vizionin lokal të shprehur përmes takimeve me palët e interesuara. Qëllimi është gjetja e ekuilibrit të duhur midis kapaciteteve të burimeve pyjore-kullosore dhe pritshmërive të përdoruesve, në përputhje me rregulloret për një mbarështim të qëndrueshëm dhe shumëfunksional.

Për punimet e terrenit nuk ka pasur tejkalim të limitit të sipërfaqes së ngastrës, kurse për inventarizimin me sipërfaqe provë distancat e matura në terren (rezja, distanca e qendrave të sipërfaqeve provë etj.) janë reduktuar në përputhje me pjerrësinë e terrenit.

Sipërfaqet provë përbëhen nga 22 sipërfaqe rrethore, bashkëqëndrore me madhësi 25 m², 200 m² dhe 400 m² (r 11.28m). Kjo formë e organizimit të sipërfaqeve provë synon që të mbulojë variacionin e dimetrave në grumbullin pyjor.

- Sipërfaqja e parë rrethore me madhësi 25m²(r = 2.82 m) shërben për matjen e rigjenerimit, drurëve me diameter bazimetrik (1.3 m nga toka) nga 2.0- .5 cm, vlerësimin e produkteve jo-drusore dhe inventarizimin e kullotave.
- Sipërfaqja e dytë rrethore me madhësi 200 m² (r = 7.98 m) shërben për matjen e drurëve me diameter bazimetrik nga 7.51 deri 27.5 cm.
- Sipërfaqja e jashtme rrethore me madhësi 400 m²(r = 11.28 m) shërben për të matur drurët me diameter bazimetrik > 27.5 cm.

Gjatë rlevimeve të terrenit ashtu edhe gjatë punimeve të zyrës nuk ka pasur shmangie nga metodologjia standarte e mbarështimit.

1.4 Informacioni i përdorur në hartimin e PMP

Materiali bazë për grumbullimin e informacionit është plani i vjetër i inventarizimit të ekonomisë pyjore “ Vajkan Libofshë“, hartat topografike e tematike të kësaj zone, informacioni respektiv i mbledhur nga përfaqësuesit e komunitetit, tabelat e prodhimit (kubaturës), projekte e studime shkencore të kryera nga specialistë të Bashkisë Fier dhe institucione të tjera projektuese e studimore. Gjithashtu ekspertët përgjegjës për hartimin e planit të mbarështimit, grumbulluan dhe dokumentacionin shtesë në lidhje me;

- Planin e Zhvillimit të Territorit të Bashkisë i ashtëquajtur "Plani i Përgjithshëm Lokal i Bashkisë"

- Informacion mbi të dhënat demografike, të drejtat e përdorimit, tregjet lokale të produkteve drusore, jodrusore dhe kullosore etj.
- Informacion mbi turizmin, edukimin dhe aktivitetet rekreacionale

I gjithë informacioni i grumbulluar do të shërbejë në të ardhmen dhe për të kryer e studime paraprake të pronës private për pronarët privatë që do të kërkojnë informacion në lidhje me:

- shtrirjen, kufijtë dhe sipërfaqen e përgjithshme të ekonomisë pyjore.
- karakteristikat e përgjithshme të fondit pyjor (sipërfaqja e veshur me pyll dhe kullota; llojet drusore përbërës; klasat e moshës; gjendja e grumbujve pyjor; rrugët që përshkojnë ekonominë pyjore).
- të dhëna të tjera të nevojshme për pronën.
- hartat pyjore etj .

Krahas informacionit të mbledhur gjatë inventarizimit në terren dhe procesit pjesmarrës, informacioni specifik që ishte i domosdoshëm të sigurohej në nivelin e Bashkisë Fier në fillim të aktiviteteve ishte:

1. Ndarjet parcelare dhe n/parcelare për ekonomia pyjore “Vajkan Libofshë” duke bërë rakordimin e kadastrës dhe ALFIS.
2. Studime të mëparshme në këtë ekonomi pyjore.
3. Aktivitete të lidhura me prodhimet drusore dhe jodrusore nga pyjet dhe kullotat;
4. Rrugët dhe infrastruktura pyjore;
5. Të dhëna historike mbi zjarret në pyje dhe rreziqet natyrore (rrëshqitjet e tokës, përmytjet, stuhitë, tharjet e drurëve).
6. Rrjeti hidrologjik dhe burimet e furnizimit me ujë.
7. Prania e aktiviteteve edukative dhe didaktike lidhur me pyjet dhe kullotat.
8. Prania e aktiviteteve turistike lidhur me pyjet dhe kullotat.
9. Prania e siteve me vlera të larta mbrojtjeje. Kjo përfshin rezervatet farore, habitatet e veçanta (liqene, pyje të brigjeve të lumenjve...), site të njohura për vlerat kulturore, peizazhe të mbrojtur.
10. Prania e aktiviteteve kërkimore në pyje dhe kullota.

2 PËRSHKRIMI I PËRGJITHSHËM I PRONËS

2.1 Informacion i përgjithshëm rreth ngastrave pyjore të ekonomisë pyjore “ Vajkan Libofshë”

Ekonomia pyjore “ Vajkan Libofshë ” bën pjesë në zonat kadastrale nr.3695, 3230, 2443 me sipërfaqe totale 88.8 ha .

Sipërfaqja pyjore e cila është objekt i këtij plani mbarështimi është pronë e Bashkisë Fier, kjo në bazë të VKM-së nr.433 date 08.06.2016 ndërkohë që për regjistrimin e pronës në ASHK procesi është në vazhdim.

Kjo ekonomi pyjore është e përbërë nga 8 ngastra dhe 6 nëngastra ku kryesisht dominojnë formacionet e trungishteve të përfaqësuar nga llojet e pishave si pisha e egër (pinus halepensis), pisha e butë (pinus pinea) , ndërkohë që formacioni i cungishteve përfaqësohet nga lisi .Formacioni i shkurreve përfaqësohet nga llojet shkurre tipike medhetare.

Grupngastrat e marra në studim shtrihen brenda territorit administrative të Bashkisë Fier, Qarku Fier dhe Njësia Administrative Mbrostar dhe Libofshë.


Kufijtë natyrale të grupngastrave pyjore janë si mëposhtë :

V – me rrethin Lushnjë

J – Fier Libofshë

P – Hekurudha Fier Libofshë

L – Rruga nacionale Fier Lushnje



Korniza ligjore mbi të cilën parashikohet realizimi i Planit të Mbarështimit është:

1. Ligji nr. 57/2020, "Për pyjet", i ndryshuar.
2. Ligji nr.10120, datë 23.04.2009 “ Për mbrojtjen e fondit të bimëve mjekësore, eterovajore e tanifere natyrore”
3. VKM nr. 433 datë 08.06.2016 “Për transferimin në pronësi të Bashkive të pyjeve dhe kullotave publik sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish komunave/bashkive”.
4. Udhëzimi nr. 1 datë “ Për rregullat, procedurat e kerkimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullusor publik”

5. VKM nr. 888 datë 27.12.2022 “ Për rastet e dhënies në përdorim dhe për ndryshimin e kategorisë së përdorimit, procedurat dhe dokumentacioni përkatës për ndryshimet e sipërfaqeve dhe pakësimin në volum nga fondi pyjor kombëtar apo zgjerimin e tyre” .
6. VKM nr. 559 datë 29.07.2022 “ Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënien në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar, për veprimtari ekonomike, si dhe për prodhimet drusore dhe jodrusore pyjore” i ndryshuar .
7. VKM nr. 297 datë 17.05.2023 “ Për miratimin e procedurave të shfrytëzimit në fondin pyjor kombëtar nga individë apo subjekte të licensuara”
8. VKM nr. 614 datë 23.10.2026 “Për miratimin e rregullave për trajtimin, shfrytëzimin, shitjen, eksportin, importin, administrimin dhe transportin e materialit drusor e të prodhimeve jodrusore pyjore, si dhe kategorizimin e rrugëve autopjore, përdorimin dhe standartet teknike të tyre”.
9. VKM nr.1080 datë 22.12.2010 “Për rregullat për parandalimin dhe shuarjen e zjarreve në pyje dhe në kullota, si dhe për krijimin e njësisë vullnetare të shuarjes së zjarreve”

2.2 TË DREJTAT E PRONËSISË



Në zbatim të VKM-së nr. 433 datë 08.06.2016 “ Për transferimin në pronësi të Bashkive të pyjeve dhe kullotave publik sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish komunave/bashkive” duke qënë se këto grupngastrash i janë transferuar Bashkisë Fier në pronësi ajo është pronare .

Aktualisht procesi i regjistrimit ka filluar dhe është në vazhdim.

Grupngastrat e marra në studim do të trajtohen me numër identifikues sipas hartave egzistuese pyjore.

2.3 Vendndodhja gjeografike dhe ndarja administrative

Sipërfaqja në fjalë,objekt i ketij Plani Mbarështimi shtrihet ne tre zona kadastrale 2443, 3230 dhe 3695, Bashkia Fier, Qarku Fier, Njësitë Administrative Libofshë dhe Mbrostar .



Sipërfaqja ka formë të shpateve, kodrinore, e përberë nga Pyje me pisha dhe lis.

Përgatitja e hartave u realizua në sistemin GIS duke respektuar standartet si dhe bazuar në sistemin e ri zyrtar KRGJSH, kompatibël me sistemin koordinativ UTM edhe atë të Gauss Kruger.

Hartat dhe ortofotot janë marrë sipas ASIG ([ëëë.asig.gov.al](http://eëë.asig.gov.al)).

2.4 Konteksti i Bashkisë dhe Ekonomisë Pyjore

Në territorin e Bashkisë Fier grup ngastrat objekt studimi menaxhohen respektivisht në Ekonominë Pyjore “ Vajkan Libofshë ”. Grup ngastrat shtrihen në territorin e kësaj ekonomie e ndarë në 8 ngastra dhe sipas Rregjistrat Kadastral të ish DSHP Fier dhe Sektorit Menaxhimit Pyjeve në Bashkinë Fier ka kodin kadastral FR 27 0 001/a,b , FR 27 00 2\b , FR 27 00 6\ a,b , FR 27 00 7, FR 27 00 8 .

2.5 Historiku i Mbarështimit të Pyjeve në Ekonominë Pyjore

Bazuar në inventarizimin e vitit 1985 të Ekonomisë Pyjore “Vajkan Libofshë” ka qënë në total 210 ha nga të cilat 121.2 ha i kanë kaluar pronarëve privatë dhe 88.8 ha kanë kaluar në pronësi të Bashkisë Fier.

Grup ngastratat pyjore që janë pronë e Bashkisë Fier janë ngastrat 1 deri në 8 të cilat janë Pyll (trungishte, cungishte dhe shkurre) me llojet drusore pishë mesdhetare, lis etj.

Grupngastrat e marra në studim janë pyllëzime artificiale pasi janë pyllëzuar pas viteve 1985 ndërkohë që nga vitet 1970 e deri në 1985 disa ngastra kanë qënë të përbëra me lis I cili më pas është shfrytëzuar dhe është pyllëzuar me pishë. Çdo ndërhyrje në këtë ekonomi pyjore është e pasqyruar në inventarizim e vitit 1985 sipas ngastrave dhe nëngastrave.

Sipas inventarizimit të vitit 1985 ekonominia pyjore ka qënë 91 % e përbërë nga cungishte lisi dhe me pas duke qënë se lisi ka qënë me një zhvillim jo normal është ndërhyrë me pyllëzime artificiale të llojit pishë e butë dhe sot kemi këtë gjendje aktuale

<u>Përdorimi i territorit</u>	<u>Sasia ha</u>	<u>%</u>
<u>Trungishte</u>	<u>9.3</u>	<u>9</u>
<u>Cungishte</u>	<u>190.8</u>	<u>91</u>
<u>Shkurre</u>	<u>0</u>	<u>0</u>
<u>Kullota</u>	<u>0</u>	<u>0</u>

Në tabelën e mësipërme jepet përshkrimi sipas inventarizimit të 1985 ndërkohë që sot kemi një ndryshim pasi trungishtet zënë një përqindje më të madhe se atëherë.

2.6 Situata demografike dhe social ekonomike

Grupngastrat e marra në studim kanë qënë bazë për sigurimin e lëndës drusore për ngrohje për komunitetin përreth si dhe kanë shërbyer për kullotjen e bagëtive.

Duke qënë se pranë këtyre grup ngastrave ndodhet dhe Manastiri i Ardenicës gjatë gjithë kohës ata kanë qënë atraksioni turistik jo vetëm për turistët por edhe për banorët e këtyre zonave në afërsi të këtij pylli.

Pavarësisht rëndësisë së tij turistike këto grup ngastrash janë gjithnjë të kërcënuar nga aktivitetet ilegale dhe mbikullotja, Bashkia do të sigurojë mbrojtjen e objektit në të gjithë perimetrin e saj .

2.7 Marketingu i produkteve pyjore drusore dhe jo drusore

Historikisht brënda parcelave, janë prodhuar dru zjarri apo lëndë ndërtimi për përdorim familjar duke ju referuar një vlere që duhej të paguanin. Për përcaktimin e çmimeve ju është referuar gjithmonë VKM-ve që kanë qënë në fuqi.

Ndërkohë që çmimet në VKM-në nr. 559 datë 29.07.2022 “ Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënie në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar,për veprimtari ekonomike, si dhe për prodhimet drusore dhe jodrusore pyjore” i ndryshuar, vazhdojnë të jenë çmimet shumë të favorshme .

Në rastin konkret Bashkia Fier mund të shesë lëndën drusore që do të rezultojë nga ndërhyrjet e propozuara sipas parimit kërkesë-ofertë, në marrëveshje me Bashkitë e tjera ose ti përdori për plotësimin e nevojave të komunitetit me dru zjarri në përputhje me përcaktimet ligjore dhe nënligjore.

2.7 Gjuetia dhe peshkimi

Në ngastrat pyjore gjenden lloje të ndryshme kafshësh siç mund të përmendim: Çakallin, Dhelprën, Derrin e eger , ndër shpendët përmendim; Thëllëzën e fushës, Turtullin, Qyqen,Mëllenjën etj.

Llojet kryesore të kafsheve dhe shpendëve që shpesh hasen në këtë ngastër janë:

- *Dhelpra(Canis vulpes)* takohet shpesh dhe është mjaft grabitqare.
- *Lepuri (Lepus europaeus)* është mjaft i pranishëm dhe takohet shpesh.
- Çakalli (Canus aureus)* është kafshë grabitqare më e vogël se ujku ushqehet me lepuj, minj, shpendë, insekte etj

2.8 Fasilitetet rekreacionale dhe didaktike

Pjesë e rëndësishme e parcelës pyjore,janë edhe pasuritë e biodiversitetit, rekreative e pisazhistike që ofron parcelat e cila krijon kushte për zhvillimin e agroturizmit dhe ekoturizmit .

Në territorin e parcelave ka vënde të cilat mund të përdoren nga privati për ambjente shlodhëse rekreacionale dhe sportive.

2.9 Prania e zonave të mbrojtura, specieve dhe stacioneve

Gjatë punimeve të terrenit, vërtetimeve të kryera, por edhe nga informacionet e studimeve dhe verifikimeve, nuk rezulton të ketë sipërfaqe të fondit pyjor që janë pjesë e Zonave të Mbrojtura në këto grup ngastra.

Gjatë trajtimit dhe propozimit të masave e punimeve gjatë periudhës në vijim, i është dhënë prioritet mbrojtjes, shtimit të llojeve të rralla të specieve të kërcënuara .

2. GJENDJA AKTUALE E PYJEVE

3.1.1. Përdorimi i territorit (aktual dhe propozimet)

Grupngastrat pyjore objekt i planit të mbarështimit sipas përdorimit të territorit (tokës) jepet në pasqyrën në vijim.

Përdorimi aktual dhe i propozuar i territorit

Tab.3.1.1.1

Përdorimi	Aktuale		E propozuar	
	Ha	%	Ha	%
Pyje	88.8	100	88.8	100
Sip. me bim.pyjore	0	0	0	0
Bujqësia	0	0	0	0
Kullota, livadhe	0	0	0	0
Urbane	0	0	0	0
Ujore	0	0	0	0
Të eroduar	0	0	0	0
Të tjera (Rrugë për korridore + sheshe, shtim, sipërfaqe për Agroturizëm dhe Ekoturizëm)	0	0	0	0
Total	88.8	100	88.8	100

Sikurse shihet në përgjithësi nuk kemi ndryshime të formës së qeverisjes së grumbullit pyjor të mbarështimit aktual me atë të propozuar.

Ndryshimi në masën 30% ,rrjedh si domosdoshmëri për hapje dhe zgjerim rrugësh ekzistuese, breza mbrojtës nga zjarri.

3.1.3.Ndarja e ngastrave në nëngastra

Duke marrë parasysh kriteret e mëposhtme nuk kemi ndarje të re të ngastrave në nëngastra .

- kriteret stacionale (prodhimtaria)
- kriteret silvikulturore (origjina, forma e qeverimit, trajtimi etj.)
- veçori të grumbujve pyjore: tipi i grumbullit, përbërja e llojeve, klasa e moshës (diferenca 1 klasë moshë e më tepër), kurorëndësia (ndryshimi mbi 0.2), struktura, cilësia e origjina e grumbullit.

3.1.4. Ndarja e pyjeve

Ruajtja e ndarjes egzistuese është bërë duke mbajtur parasysh ndarjen e vjetër duke respektuar kufijtë ekzistues. Gjate punës në terren u konstatua se grupngastrat e marra në studim ndahen në 8 ngastra dhe 6 nëngastra të ekonomisë pyjore “Vajkan Libofshë”

4 KUSHTET STACIONALE

4.1. Klima

Grupngastrat objekt i këtij plani mbarështimi gjenden në zonën klimaterike mesdhetare, me një verë të nxehtë dhe të thatë dhe dimër të butë dhe të lagësht.

Sasia e rreshjeve vjetore është 980-1000 mm në vit.

Temperatura mesatare në verë 37 ° c dhe në dimër 0 ° c.

Erat fryjnë nga pjesa veriore dhe veriperëndimore gjate verës dhe nga jugu gjatë dimrit.

Ditët me reshje gjate verës janë të pakta dhe thuajse nuk bien me javë të tëra

Fakti që është në një lartësi të vogël nga niveli i detit e zbut mjaft klimën, megjithëse lartësia mbi nivelin e detit shkon deri 150 m .

4.2 Topografia dhe morfologjia

Nisur nga lartësia mbi nivelin e detit si dhe duke u bazuar në konfiguracionin e terrenit grupngastrat kanë një shtrirje të lartësive nga 60 m deri 150 m mbi nivelin e detit, lartësia mesatare zotëruese mbi nivelin e detit është 85 m.

Përsa i përket kundrejtimit dhe formës së terrenit themi se grupngastrat nuk kanë kundrejtime të ndryshme pasi terreni është shpat, kodrinor dhe grop.

4.3. Gjeologjia

Gjatë përshkrimit të grupngastrave në terren, përcaktuam edhe morfologjinë, gjeologjinë, tokën, pjerrësinë, kundrejtimin, altituden etj, e cila i bashkëngjitet projektit. Kështu mund të themi se territori i grupngastrave të marra në studim përbëhet nga sipërfaqe të cilat kanë një pjerrësi që varjon nga 15 deri 20 %, forma e terrenit është shpat .

Grupngastrat përbëhen nga formacion tokash të kafta subargjilore .

4.4 Toka

Toka është e hinjtë kafe subargjilore , ku rriten bimësi tipike për zonën mesdhetare mesatare dhe e pasur në përbërje të saj me elementë.

E gjithë sipërfaqja është përgjithësisht shpat me pjerrësi që varjon nga 15 deri 20 % .

Lartësia mbi nivelin e detit shkon 60 deri 150 m mbi nivelin e detit.

4.5. Rrjeti hidrologjik dhe burimet e furnizimit me ujë

Grupngastrat pyjore të marrë në studim janë të varfra me rrjetin hidrologjik i vetemi burim uji është një përrua i cili përshkon grup ngastrat nga 1 deri ne 3 i cili është i mbushur me ujë gjatë dimrit dhe gjatë verës është i thatë. Ky përrua që gjatë dimrit mbushet me ujë shkakton dhe fenomenin e erozionit.

4.6. Erozioni në shpate dhe rrjedhjet ujore.

Duke qënë se grupngastrat kanë formë të shpatit me kundrejtime të ndryshme dhe me pjerrësi që varjon nga 15 deri 20 % kemi dhe fenomenin e erozionit të lehtë .

Më shpesh shihet erozioni sipërfaqësor në pjesët ku mungon bimësia pra erozion eolik .

4.7. Rrëshqitjet

Rrëshqitjet si fenomen nuk hasen në grupngastrat pyjore objekt studimi.

5. VEGJETACIONI DHE BIODIVERSITETI

5.1. Brezat bioklimatike

Brezi i pyjeve dhe shkurreve fletore termofile hasen te llojet si pisha mesdhetare të përfaqësuara nga llojet si pisha e egër (pinus halepensis), pisha e butë (pinus pinea).

Ndërkohë që kemi cungishtet të përfaqësuara nga lloje si lisi dhe shkurre të dominuar nga gjineshtra etj. Bimësia barishore përfaqësohet nga llojet e familjeve graminore dhe leguminoze.

5.2. Pyjet dhe kullotat

Bazuar në informacionin e përshkrimit parcelar shpërndarja e pyjeve dhe kullotave në këtë pjesë të ekonomisë pyjore të marrë në studim jepet si më poshtë:

Tab.5.2.1

– Siperfaqja totale e ngastrës pyjore	88.8 ha
– Siperfaqja e mbuluar nga pyjet	85.2 ha
– Siperfaqja e mbuluar nga pyjet	91 %
– Siperfaqja e mbuluar nga shkurret	3.6
– Siperfaqja e mbuluar nga shkurret	9 %
– Siperfaqja e mbuluar nga kullotat	0
– Siperfaqja e mbuluar nga kullotat	0

– Toke bujqesore + troje	0
– Toke bujqesore + troje	0
– Sip. jo pyjore	0 ha

Tab.5.2.2

Sip totale (ha)	Pyje (ha)	Pyje (%)	Shkurre (ha)	Shkurre (%)	Kullota (ha)	Kullota (%)	Te tjera (ha)	Te tjera (%)
88.8	85.2	100	3.6	9	0	0	0	0

5.3. Tipet e pyjeve

Për sipërfaqen e grupngastrave që janë marrë në studim shpërndarja e sipërfaqes sipas tipit të pyjeve është si më poshtë:

Tipi i pyjeve	Sip(ha)	% ndaj sipërfaqes pyjore marrë ne studim	% ndaj sipërfaqes totale të ngastrave
Pyje dominuar nga pisha.m	24	38	38
Pyje te dominuar nga lisi	61.2	53	53
Pyje te dominuar nga shkurre	3.6	9	9
Totali	88.8	100	100

5.5. Tipet potenciale të vegjetacionit

Vetë shkalla verikale e shtrirjes së ngastrës ka favorizuar zhvillimin dhe ndërthurjen e llojeve të ndryshëm të drurëve dhe shkurreve. Në këto grupngastrash takohen pyje cungishte që përbëjnë 53%, të sipërfaqes totale të tyre, ku dominon lisi si lloj kryesor dhe pyje trungishte pishë mesdhetare 38% dhe 9 % shkurre. Nga sipërfaqja e përgjithshme e pyjeve 100 % e tyre janë me funksion prodhues.

Në tabelën e mëposhtme jepen pyjet sipas funksionit të tyre

Tab.5.5.1

<i>Ekonomia Pyjore</i>	<i>Vajkan Libofshë</i>		
Tipi i vegjetacionit	Funksioni		TOTALI ndaj ngastrave
	Prodhues	Mbrojtës	

	Sip. ha	%	Sip. ha	%	Sip. ha	%
Formacion pyje pishe.m	24	38			24	38
Formacione shkurre me mërsin, xinë, gjineshtër, rrushkull etj	3.6	9			3.6	9
Formacione pyjesh cungishte	61.2	53			61.2	53
TOTALI I	88.2	100			88.8	100

5.6 Biodiversiteti

Grumbulli i sipërfaqeve të marra në studim identifikohet si grumbull pyjor artificial që i perkasin kodit (PN) 24 ha sipërfaqe e mbjellë me fidanë dhe sipërfaqe që është pyllëzuar në mënyrë natyrale me llojin lis. Llojet kryesore të këtyre grup ngastrave janë përshkruar si mëposhtë.

Trungishtet përfaqësohen nga :

- **Pisha mesdhetare, pishë e butë (pinus pinea) dhe pishë e egër (pinus halepensis)** e cila takohet në ngastren 2/b dhe 1/a këto janë grupngastrat që janë në pronësi të Bashkisë Fier.
 - **Cungishtet** përfaqësohet nga llojet autoktone si lisi, bulgeri .
 - **Shkurret** përfaqësohen nga lloje si gjineshtra, shkoza, rrushkulli, vidhi etj

5.7. Rreziqet për biodiversitetin dhe efektet mbi planifikimin.

Biodiversiteti i këtyre grupngastrave është nën presion për përdorim bujqësor e blegtoral, për prodhim të lëndës drusore, dru zjarri etj. Një rrezik i vazhdueshëm për këto grupngastra janë prerjet e paligjshme, gjuetia e paligjshme dhe kullotja e paligjshme.

Gjithashtu një rrezik ndaj biodiversitetit janë edhe zjarret aksidentale apo të qëllimshme kjo pasi grupngastrat ndodhen shumë afër qendrave të banuara dhe ato shpesh janë objekt i këtyre veprave penale.

Rrezik paraqiten edhe katastrofat natyrore si erërat e fuqishme të cilat shkaktojnë rënien masive të drurëve.

Faktori kryesor për uljen e rreziqeve dhe menaxhimin sa më të mirë të tyre do të jetë bashkëpunimi midis gjithë aktorëve të interesuar si Njësia administrative, Bashkia Fier dhe Drejtoria e Pyjeve.

5.8 Mundësitë për aktivitetet didaktike dhe kërkim shkencor.

Përgjithësisht grupngastrat e marra në studim janë të mbrritshme me rrugë auto që ofron mundësi në mbrritjen e të gjithë sipërfaqes pronë e Bashkisë Fier. Këtu mund të zhvillohen aktivitete didaktiko-shkencore sepse kemi larmi të madhe të specieve bimore dhe shtazore, kemi stade të ndryshme të

zhvillimit të pyjeve ku mund të aplikojmë ndërhyrje të mirëfillta tekniko-silvikulturore dhe të kryejmë vëzhgime shkencore.

6. ANALIZA E PYJEVE

6.1. Analiza e të dhënave për Pyjet

Të dhënat e grumbulluara në terren janë përpunuar dhe me to janë përpiluar tabelat. Analiza e të dhënave është kryer duke u bazuar në treguesit që rezultojnë nga përpunimi.

Tabelat japin të dhëna të ndryshme për grumbullin dhe orientojnë mbarështuesin në përcaktimin e objektivave dhe ndërhyrjeve në grumbujt pyjor, për 10 vitet e vlefshmërisë së këtij plani mbarështimi.

Në çështjet në vazhdim do të trajtohen dhe analizohen pikërisht këta tregues të grumbullit pyjor me në hollësi. Do të analizohen tipet e grumbujve pyjor, përqindja që ata zënë kundrejt totalit të parcelës, forma e qeverisjes si dhe grupimi i grumbullit pyjor sipas klasave të moshës. Volumi lëndor ka rëndësi në këtë analizë.

6.1.1 Analiza e tipeve të pyjeve

Në ngastër tipet e pyjeve brenda zonës pyjore të ndara sipas kategorive po i rendisim në tabelen 6.1.1.1, si më poshtë vijon:

Tipet e grumbujve pyjor aktual dhe përqindja ndaj totalit të sipërfaqes Tab. 6.1.1.1

Tipi i grumbullit	Sip.Ha	% ndaj totalit pasurise
Pyje te dominuar nga Pishë.m	24	38
Pyje te dominuar nga lisi	61.2	53
Pyje te dominuar nga shkurret	3.6	9
Totali	88.8	100

Në vijim jepet analiza e tipeve të pyjeve (Tabela 6.1.1.2) ku përfshihen sipërfaqja, forma e qeverisjes, volumi në m³/ha dhe volume total ne m³.

Parcela	N/parc	Kodi unik	Tipi pyllit	Sip ha	Kl moshes	Qeverisja	Vol m ³ /ha	Vol Total m ³
1	a	FR27001a	PIB	20	3	Trungishte	75	1500
	b	FR27001b	LIS	6	3	Cungishte	20	120
2	b	FR27002b	PIB	4	3	Trungishte	75	360
6	a	FR27006a	LIS	34.5	3	Cungishte	20	690
	b	FR27006b	GJIN	3.6	3	Shkurre	10	36
7		FR27007	LIS	19.6	3	Cungishte	20	392
8		FR27008	LIS	1.1	3	Cungishte	20	22
		TOTALI		88.8				3224

Në tabelën e mëposhtme jepet shpërndarja sipas formës së qeverisjes së ekonomisë pyjore për të cilën hartohet dhe plani i mbarështimit .

TRUNGISHTE

Kodi kadastral	Ekonomia Pyjore/Kullosore	Ngastra nëngastra	Sipërfaqja HA	Kategoria përd. të territorit	Emërtesa popullore
FR27001a	Vajkan Libofshë	1a	20	trungishte	Mali Libofshës
FR27002b	Vajkan Libofshë	2b	4	trungishte	Gropa e Libofshës

CUNGISHTE

Kodi kadastral	Ekonomia Pyjore/Kullosore	Ngastra nëngastra	Sipërfaqja HA	Kategoria përdorimit të territorit	Emërtesa popullore
FR27001b	Vajkan Libofshë	1b	6	cungishte	Mali Libofshës
FR27006a	Vajkan Libofshë	6a	34.5	cungishte	Vajkan
FR27007	Vajkan Libofshë	7	19.6	cungishte	Vajkan
FR27008	Vajkan Libofshë	8	1.1	cungishte	Vajkan

SHKURRE

Kodi kadastral	Ekonomia Pyjore/Kullosore	Ngastra nëngastra	Sipërfaqja HA	Kategoria përdorimit të territorit	Emertesa popullore
FR27006b	Vajkan Libofshë	6b	3.6	shkurre	Vajkan

6.1.3 Struktura e pyjeve sipas klasave të moshës dhe klasave të prodhimit.

Grupngastrat e marra në studim ndodhen në klasën e parë, të dytë dhe të tretë të moshës. Sipërfaqja sipas formës së qeverisjes kundrejt klasave të moshës jepet në tabelën e mëposhtme:

Klasa e moshës	Siperfaqja në ha						
	Trungishte	Cungishte	Trung+ Cung	Cung+ Trung	Shkurre	Gjithsej	%
I						0	
II						0	
III	24				3.6	27.6	47
IV		61.2				61.2	53

V							
VI							
VII							
Total	24	61.2	0	0	3.6	88.8	100

Volumi total sipas formës së qeverisjes kundrejt klasave të moshës është si më poshtë:

Tab.6.1.3.2

Klasa e moshes			Volumi ne m3				
	Trungishte	Cungishte	Trung+ Cung	Cung+ Trung	Shkurret	Gjithsej	%
I							
II							
III	1800				22	1822	99
IV		1402				1402	
V							
VI							
Total	1800	1424			22	3224	100

7. REZULTATET E INVENTARIZIMIT TË PYJEVE

7.1 Rezultatet e Inventarizimit të Pyjeve

7.1.1. Analiza statistikore e Inventarizimit

Numri i sipërfaqeve prove llogaritet përpara se të fillojë puna në terren dhe tregon numrin e vrojtimeve të nevojshme për të arritur një nivel saktësie të caktuar. Për këtë qëllim sipërfaqja e ekonomisë pyjore ndahet fillimisht sipas formës së qeverisjes dhe me pas secila formë qeverisje ndahet në njësi homogjene sipas: (i) tipit të pyllit ose (ii) klasës së moshës. Llogaritja e numrit të domosdoshëm të sipërfaqeve provë për klasë moshe dhe tipi grumbulli llogaritet me anë të formulës:

$$n = \frac{t^2 \cdot S_{\%}^2}{\Delta_{\%}^2}$$

ku: t^2 - parametri i Shperndarjes Student ($t = 2$; $P < 0.05$)
 $S_{\%}$ - koeficienti i variacionit (e.g. 30% për nënshtresen tip pylli/klase moshe)
 $\Delta_{\%}$ – gabimi i lejuar

Në këtë rast sipërfaqet provë janë marrë nga sistemi ALFIS dhe për këtë ekonomi pyjore kemi gjithsej 22 sipërfaqe provë.

7.1.2. Volumi dhe rritja në volum e grumbullit pyjor.

Një pasqyrë e plotë e të dhënave të karakteristikave të ngastrës jepet në tabelën me anekse të këtij plani, bashkëlidhur këtij relacioni si dhe për lehtësi të përpunimit gjenden edhe në programin e përpunimit të të dhënave. Në këtë tabelë paraqiten në mënyrë të hollësishme të dhënat e n/ngastrës si: sipërfaqja, funksioni, qeverisja, kurorëndësia, lloji drunor, moshë, lartësia zotëruese, diametri mesatar, sipërfaqja bazimetrike, numri i drurëve/ha, vëllimi m^3/ha , rritja vijuese, mesatare/ha. Duke patur parasysh të dhënat e mësipërme do të parashikohen objektivat e mbarështimit si dhe masat specifike silvikulturale për ngastrën.

Grumbulli Pyjor është përcaktuar me funksion prodhues prandaj do të trajtohet me punime rigjeneruese e shëndetësore konform ligjit dhe do të trajtohet me masa silvikulturale si: përmirësime pyjore, prerje shëndetësore/ricungime etj.

Pyje trungishte, shkurre dhe cungishte (me volum drusor) gjithsej janë 88.8 ha me volum total $3224 m^3$, nga të cilët sipas formës së qeverisjes Trungishte 24 ha dhe volum $1800 m^3$, Cungishte 61.2 ha me volum $1402 m^3$ dhe shkurre 3.6 ha me volum $22 m^3$.

Rritja mesatare e grumbullit është:

Trungishte $1.5 m^3/ha \text{ vit} \times 24 ha = 36 m^3 \text{ vit}$

Cungishte $0.5 m^3/vit \times 61.2 ha = 30.6 m^3 \text{ vit}$

Shkurre $0.3 m^3 /vit \times 3.6 ha = 1.08 m^3 / vit$.

7.1.3 Struktura Vertikale

Grumbulli pyjor i marrë në studim në përgjithësi ka strukturë vertikale një katëshe është një katësh kjo për faktin se janë të pyllëzuar vetëm me një lloj dhe nënpylli është i pakët.

7.1.4 Cilësia e materialit drusor

Nga të dhënat e Sipërfaqeve prove dhe vrojtimit e kryera në terren rezulton se në trungishte drurët nuk janë të zhvilluar mirë nga ana fiziologjike pasi kanë një diamtër mesatar 20 deri 22 cm dhe lartësia shkon deri 14 m dhe këtu po flasim për një grumbull të moshës 45 vjecare, ndërkohë që në grumbujt me lis paraqitet një gjendje jo e mirë e zhvillimit të tyre kjo duke ju referuar treguesve dentrometrik që ashtu si tek trungishtet edhe te cungishtet japin një pasqyrë të qartë të mos zhvillimit të tyre të mirë për shkak të mungesës së dritës si një nga faktorët kryesor për zhvillimin e tyre si dhe kurorë dëndësia e cila aktualisht është 0.9 por shkon edhe 1 pra totalisht e mbyllur.

Masat silvikulturore që parashikohen të zbatohen në grumbujt pyjore, do të rrisin cilesinë e lëndës drusore, duke bërë që të dominojë cilesia mesatare dhe e lartë si dhe do shtohen sipërfaqet e gjelbërta me pyllëzime artificiale .

7.1.5 Biomasa dhe Faktorët e Ekspansionit të Biomases

Sipas përcaktimit të dhënë në Direktiven 2009/28/CE, biomasa është “fraksioni biodegradues i produkteve, mbetjeve dhe mbeturinave me origjinë biologjike nga bujqësia (përfshirë substancat e bimëve dhe kafshëve), pyllëtaria dhe industritë përkatëse që përfshijnë peshkimin dhe akuakulturën, si

dhe fraksioni biodegradues i mbetjeve industriale dhe bashkiake. Pyjet janë burim shumë i rëndësishëm i prodhimit të biomasës. Së pari, biomasa është energji. Lënda drusore zë rreth 35-40% të energjisë për ngrohje në banesa.

Sipas përllëgaritjeve për pronën private e marrë në studim, si biomase në dispozicion për plotësimin e nevojave energjitike mund të merret vëllimi i materialit drusor që del nga masat silvikulturore të planifikuara për dhjetë vitet që zbatohet ky plan mbarështimi.

7.2. Gjendja shëndetësore dhe fitosanitare

Gjendja shëndetësore dhe fitosanitare e grupngastrat, gjykohet të jetë përgjithësisht e mirë. Pozicionimi i grumbullit natyralë në kondicione gjeografike sipas zonimit natyral, nuk sjell pasoja dhe ndikime mbi gjendjen shëndetësore dhe fito-sanitare të tyre. Në ngastrat objekt studimi ka prezencë të grumbujve artificialë. Pavaresisht nderhyrjeve, grumbulli pyjor ka ndjekur dinamiken e tij natyrore të zhvillimit.

7.2.1. Drurët e tharë

Në përgjithësi nuk kemi raste të tharjes së drurëve kjo si rezultat i procesit natyror të rritjes dhe konkurrencës që ekziston ndërmjet drurëve dhe llojeve pyjore.

7.2.2. Dëmtimet e tjera

Dëmtime të tjera që i janë krijuar grumbullit pyjor janë prerja në mënyrë të paligjshme dhe pa kriter të pyllit ku dëmtimin më të madh e ka pësuar lisi.

Ndërkohë që kullotja pa kriter në këta grumbuj pyjor kanë sjell dhe degradimin e një pjesë të grumbullit pyjor.

Propozimi i masave teknike që ndikojnë në përmirësimin e gjendjes shëndetësore të pyjeve do të jetë një nga objektivat e planit të mbarështimit.

7.3.1 Prerjet e paligjshme, gjendja aktuale dhe efektet në procesin e planifikimit.

Më parë kur pyjet menaxhohesh nga Drejtoritë e Shërbimit Pyjor në këtë zonë nuk kishte prerje ilegale ndërkohë që tani janë të pranishme në të gjitha grupngastrat e marra në studim. Duke qenë se është pyll me pisha dhe lis është afër qëndrave të banuara ka patur tendencë dëmtimesh për përdorim për ngrohje dhe kullotje.

7.3.2 Impakti i prerjeve ilegale në planifikimin dhe mbarështimin e pyjeve

Pyjet në këto grupngastra dhe në këtë zonë përbëjnë një pasuri natyrore me vlerë dhe interes të veçantë, për vlerat e larta të biodiversitetit si dhe të faktit që pyjet shërbejnë si një burim i mirë të ardhurash dhe funksion rekreativ dhe çlodhës.

Pavarsisht ruajtjes që i është bërë këtij pylli prerjet ilegale kanë qenë prezent dhe kanë ndikuar si në menaxhimin e pyjeve por edhe në ndryshimin e klimës përrreth.

8. OBJEKTIVAT E MBARËSHTIMIT TË PYJEVE

8.1. Objektivat e përgjithshme per planifikimin afat-gjatë

Pyjet janë një pasuri dhe trashëgimni e çmuar kombëtare. Në Nenin 1 të Ligji 57/2020, datë 30.04.2020, “Për pyjet” citohet: *Qëllimi i këtij ligji është mbrojtja e pyjeve si pasuri me rëndësi të veçantë, për vlerat e mëdha dhe të pazëvendësueshme në mbrojtjen e klimës, të tokës, ruajtjen dhe përmirësimin e potencialeve prodhuese, të ekuilibrave të mjedisit natyror, biodiversitetit, burimeve gjenetike dhe regjimit hidrik, si detyrime me interes kombëtar dhe ndërkombëtar.*

Gjatë hartimit të PMP u krye studimi i territorit, marrja e të dhënave, matjet në pyje, si dhe takime me grupe interesi me synim:

- Bashkërendimin me aktorët lokale që veprojnë në zonë për të ndaluar prerjet abuzive e degradimin e pyjeve.
- Përfshirjen dhe angazhimin i aktorëve lokal.
- Trajnimin profesional të aktorëve në pyje, në të gjitha nivelet. (punëtorë, teknike, udhërrëfyes të guidave të natyrës)
- Nxitjen dhe përfitimin e të ardhurave përmes zhvillimit të mundësive rikrijuese, turizmit dhe agropylltarisë ;
- Rehabilitimin e përmirësimin e sipërfaqeve pyjore, për mbrojtjen e ekosistemeve natyrore, përmirësimin e peisazheve rurale dhe ruajtjen e biodiversitetit.
- Mirëmenaxhimin e qëndrueshëm dhe shumë funksional të pyjeve;
- Ripërcaktimin i drejtimeve të punës sipas koncepteve afat-gjatë të zhvillimit për administrimin dhe menaxhimin e pyjeve.
- Përdorimin dhe zhvillimin i qëndrueshëm i pyjeve mbi bazën e vlerësimit me kritere bashkëkohore të gjendjes biologjike dhe ekologjike të tyre në mënyrë që të përcaktohet realisht potenciali i tyre prodhues, pa dëmtuar biodiversitetin dhe pa cënuar çështjet e mbrojtjes së mjedisit.
- Përcaktimin e rolit dhe mënyrës së përfshirjes së palëve të interesuara gjatë hartimit dhe zbatimit të këtij plani.

8.2. Objektivat Kombëtare për Zhvillimin e Pyjeve

Qëllimi dhe objektivat kryesore kombëtare janë:

Të sigurohet ruajtja dhe mbrojtja e integritetit të burimeve pyjore si pasuri natyrore të qëndrueshme dhe zhvillimi shumëfunksional si pasuri natyrore e qëndrueshme

Zbatimi i këtij Plani Mbarështimi do të kryhet në përputhje me objektivat kombëtare të zhvillimit të Pyjeve.

8.3. Pajtueshmëria e PMP me planifikimin rajonal dhe atë në nivel Bashkie

Zbatimi i këtij plani do të bëhet në përputhshmëri me Planin e Përgjithshëm Vendor (PPV) të Bashkisë Fier , Qarku Fier.

8.4. Objektivat kryesore të PMP

Plani i Mbarështimit ka disa objektiva kryesore të cilat janë:

- Harmonizimi i interesave midis aktorëve dhe te pjesëmarrësve të tjerë veprues në territorin e kësaj ekonomie në përputhje me mundësinë aktuale dhe potenciale të pyllit.
- Grumbullimi i informacionit të shumfishtë, evidentimi i faktorëve socialë dhe ekonomike që ndikojnë në një mbarështim të qëndrueshëm të pyjeve.
- Identifikimi i masave që do të merren në të ardhmen dhe harmonizimin e të gjithë faktorëve veprues për përcaktimin e objektivave specifike që janë rezultat logjik i një mbarështimi bashkëkohor.

8.5.1 Objektivat specifike të ngastrës (NJM)

Objektivat specifike të ngastrës janë:

- Evidentimi i gjendjes aktuale në tërë hapësirën e ekonomisë pyjore me anë të matjeve direkte në terren.
- Bashkëpunimi që në fazën e hartimit të PMP me përdoruesit dhe palët e tjera të interesuara.
- Përdorimi dhe zhvillimi i qëndrueshëm i pyjeve mbi bazën e vlerësimit me kritere bashkëkohore të gjendjes biologjike dhe ekologjike të tyre.
- Organizimi i takimeve për diskutimin e masave që propozohen dhe detajimin operacional të planit afatmesëm dhe afatgjatë.

8.5.2 Objektivat specifike mbi përdorimin e tokës, funksionin dhe formën e qeverisjes/mbarështimit.

Mbarështimi aktual nga ai i propozuar për sa i takon përdorimit të territorit, formës së qeverisjes dhe funksioneve nuk ka ndryshime për vetë synimin e zhvillimit të pyjeve dhe gjendjes aktuale të grupngastrave. Duke qenë se është mes një zone të banuar dhe për më tepër afër qytetit të Fierit zhvillimi i ekoturizmit i shoqëruar me aktivitete për çlodhje dhe argëtim në funksion të një mjedisi ekologjik është me se i nevojshëm, .

Ndryshimet në hapjen e shtigjeve dhe vendeve për mbarështimin e faunës janë tepër të rëndësishme për mbrojtjen e pasurisë pyjore.

8.5.3 Objektivat specifike mbi tipet e pyjeve

Objektivi specifik për funksion prodhues janë masat me punime rehabilituese duke i dhënë pyllit vlerat e një parku nëpërmjet punimeve shëndetësore dhe krijimin e korridoreve me prerje suksesive, si dhe sigurimi i gjeneratës së re të pyjeve, vjelja e një sasive të konsiderueshme materiali drusor, pa cënuar vijueshmërinë e prodhimeve drusore gjatë gjithë ciklit të prodhimit.

Mbarështimi i qëndrueshëm i pyjeve deri në arritjen e moshës së shfrytëzueshmërisë nëpërmjet planifikimit të ndërhyrjeve me punime silvikulturore do të synojë sigurimin e të ardhurave nga pylli me sa më pak pasoja negative në mjedis e duke ruajtur biodiversitetin.

Nga ndërhyrjet me pastrime të nënpyllit, hapjen e korridoreve për mbrojtjen nga zjarri të cilët do të shërbejnë edhe si shtigje për kalimin e truistëve etj.

Rrallimet në trungishte do të diferencojnë drurët me cilësi më të mirë ose të quajtur ndryshe si drurët e së ardhmes, duke siguruar një gjeneratë të re me trung të drejtë e cilindrik dhe kurorë pak a shumë simetrike.

Objektivi final do të jetë krijimi i pyjeve me cilësi të mesme për prodhim lëndë punimi të mesme e të hollë.

8.5.4 Objektivat specifike silvikulturore

Në përshtatje të mjedisit lokal dhe karakteristikave të grumbullit, do të zbatohet sisteme silvikulturore optimale për realizimin e një përdorimi të qëndrueshëm dhe afatgjatë të pyjeve.

Do të kryhen një sërë punimesh silvikulturore duke filluar nga pastrimet e nënpyllit në cungishte, rrallimet në trungishte, prerjet e ndryshme silvikulturore si dhe hapje koridoresh për mbrojtjen nga zjarret. Me anë të tyre synohet përmirësimi i gjendjes aktuale duke gërshetuar të gjithë komponentët së bashku (teknike dhe sociale).

Ndërhyrjet silvikulturore do të kryhen në përshtatje me objektivat e planit të mbarështimit, kushtet e stacionit dhe cilësinë e grumbullit.

Objektivat kryesore silvikulturore konsistojnë në :

- Prerje shëndetësuese që do të konsistojnë në heqjen e drurëve të pazhvilluar mirë me qëllim që ti jepet përparësi drurëve me tregues optimal dendrometrik.
- Sigurimin e ripërtëritjes duke ndërhyrë me pyllëzime artificiale atje ku do të shikohet e nevojshme.
- Realizimin e qëllimit të Planit të Mbarështimit për ruajtjen e biodiversitetit.

Të dhënat për sipërfaqen dhe koston e çdo objektivi jepen në kapitujt përkatës.

8.5.5 Objektivat specifik për kullotat

Nuk ka sipërfaqe kullosore por përdorim dhe realizim kullote në pyll ndaj synohet përmirësimi i infrastrukturës por dhe shmangia e mbikullotjes.

8.5.6 Objektivat specifik mbi biodiversitetin

Detyra jonë është që këtë biodiversitet, ta mbrojmë dhe ta shtojmë, me synim për ta bërë me atraktive zonën, me drejtim zhvillimin e agroturizmit dhe turizmit natyror. Rreziqet për biodiversitetin kanë qenë dhe mbeten prerjet illegale, mbikullotja në afërsi të fshatit dhe zjarret.

Për përmirësimin e biodiversitetit synojmë veçanërisht llojet dhe varietetet gjenetike.

8.5.7 Objektivat specifik mbi gjendjen shëndetësore

Vëzhgimet e kryera në terren tregojnë se kjo ekonomi pyjore nuk paraqet probleme shqetësuese për sa i takon gjendjes fitosanitare. Prejet ilegale janë dhe mbeten problem shqetësues për pyjet dhe administratën pyjore. Për të frenuar këtë fenomen rekomandohet marrje e përgjegjësisë jo vetëm nga personat përgjegjës apo struktura e Pyjeve të Bashkisë direkt për mbrojtjen e pyjeve por edhe nga institucione të tjera të pushtetit qendror dhe lokal.

Një gjë e tillë është e parashikuar edhe në strategjinë e zhvillimit të sektorit të pyjeve.

8.5.8 Objektivat specifik mbi faunën

Për mbarështimin e gjahut objektiv kryesor për periudhën e vlefshmërisë së planit do të jetë krijimi i kushteve të përshtatshme për ushqim, riprodhim dhe folezim.

Pasuria faunistike mund të shndërrohet në një bazë për mbarështimin e faunës së egër në këtë ekonomi pyjore.

Kryerja e një inventari të gjahut mbi kritere tekniko-shkencore do të ndihmonte së tepërmi në monitorimin e popullatave dhe përcaktimin e gjendjes së tyre. Me një informacion të tillë mund të merren masa të plota për mbarështimin shkencor të gjahut.

8.5.9 Objektivat specifik për pyjet me funksion rekreacioni

Për realizimin e objektivave të vendosura për pyjet me funksion rekreacioni duhet në fillim të krijojmë mundësinë e zhvillimit të aktiviteteve turistike rekreative dhe çlodhëse për njerzit. Kjo gjë arrihet duke bërë prezent të mirat dhe produktet që ofrojnë pyjet e kësaj ekonomie pyjore tek operatorët turistik që kërkojnë të zhvillojnë të tilla aktivitete.

Bashkëpunimi me zyrat e promovimit në bashki, në prodhimin e fletëpalosjeve dhe guida turistike si dhe duhet të nxiten banorët e zonës të zhvillojnë turizmin familjar.

8. MASAT MBROJTËSE PËR PARANDALIMIN E ZJARREVE

8.1 Analiza e riskut nga zjarri në territorin përkatës.

Për të bërë një analizë të rriskut të zjarreve për pyjet në këtë ekonomi pyjore do ti referohemi pak historikut të zjarreve në këtë zone dhe disa nga treguesit që do të shikohen do të jenë shpeshtësia e rasteve të zjarrit të rëna në vit në këtë zonë, masën vegjetative të dëmtuar nga zjarret e rënë si dhe impaktin që kanë pasur zjarret e rënë në këtë zonë jo vetëm mbi speciet pyjore por edhe biodiversitetin e zonës.

Duke bërë një analizë të tillë shohim se nga historiku shpeshtësia e zjarreve në këtë zonë ka qënë e pakët për mos të thënë se nuk kemi pasur raste zjarri fare në këtë ekonomi pyjor pasi ka pasur raste sporadike të zjarreve sipërfaqësor por nuk kanë pasur dëme.

8.2 Identifikimi dhe hartëzimi i zonave me risk të lartë zjarri.

Duke ju referuar zonës ku shtrihet kjo ekonomi pyjore terreni i saj kryesisht është kodrinor ku një pjesë e saj është në formë grope por e rrethuar nga kodra të vogla nëse mund ti quajmë kështu.

Pjesa që mund ta quajmë që është e rrezikuar nga zjarri janë pjesa kodrinore e cila është e përbër nga lloje drunor të lisit e cila është objekt shumë i ekspozuar nga zjarri kjo për faktin se aty nuk është ndërhyrë me punime për mbrojtjen nga zjarri asnjëherë dhe bimësia është shumë e dendur.

Pjesa tjetër që është risk për zjarret është zona e pishave të cilat janë të dendura dhe mungojnë rruget që të ndërhyet në raste zjarri.

8.3 Planifikimi i masave infrastrukturore për parandalimin dhe kontrollin e zjarreve.

Përsa i përket masave për mbrojtjen nga zjarri vec masave sensibilizuese që janë dëgjesat publike apo vendosja e tabelave paralajmëruese “ Mbroni Pyjet nga zjarri” etj kemi menduar të ndërhyjmë edhe me punime për mbrojtjen nga zjarri duke planifikuar hapjen ose me saktë zgjerimin e koridoreve egzistues .

Janë tre koridore egzistues tek të cilët nuk është ndërhyrë asnjëherë dhe rihapja e tyre do të bënte të mundur kalimin e mjeteve zjarrfikese në raste zjarri .

8.4 Masat për menaxhimin e vegjetacionit dhe reduktimin e materialit djegës.

Përsa u përket masave për menaxhimin e vegjetacionit kemi planifikuar punime silvokulturale si pastrimin e ngastrave nga nenpylli i dendur i cili në raste zjarri ndikon negativisht në përshkallëzimin e tij si dhe janë planifikuar ndërhyrje me ricungimin e lisit duke ulur kështu shkallën e dendësisë së tij i cili në gjendjen që është është burim zjarri real .

9.MASAT E PLANIFIKUARA NË KUADËR TË MBARËSHTIMIT TË PYJEVE

9.1. Prerja vjetore e lejuar/mundësia vjetore e shfrytëzimit.

Nga analiza e grumbullit pyjor të grupngastrave të marra në studim rezulton se pyjet trungishte me një sipërfaqe prej 24 ha, janë në fazën e zhvillimit të imshatjës së moçme. Konsatohet se grumbulli pyjor që është në këto faza zhvillimi ka kurorëdëndësi të lartë dhe se për një periudhë të gjatë kohore nuk janë kryer punime silvikulturore.

Ndërkohë që cungishtja është në fazën e zhvillimit të rinisë dhe shkurret janë faza e zhvillimit të rinisë.

Nisur nga arsyet e sipërpërmendura në këtë plan mbarështimi janë planifikuar ndërhyrje me rrallime duke hequr deri në 20 - 30% të volumit të lëndës drusore si dhe pyllëzime duke pyllëzuar ngastrat që janë boshe dhe ato që do të shfrytëzohen.

Gjithashtu pyllëzime janë planifikuar edhe në ngastrat ku volumi drusor është i papërfillshëm sic është rasti i ngastrës 6,7 dhe 8 .

Pastrimet e ngastrave ku nënpylli është shumë i dendur. Prerje në breza për hapje rrugësh dhe korridoresh për mbrojtjen e pyjeve nga zjarri, heqje drurësh të rrëzuar e përkulur në gjendje shëndetësore të dobët e të pavlefshëm.

Të gjitha produktet pyjore që do të vilen në periudhën 10-të vjeçare janë ato që do të rezultojnë prej trajtimit silvikulturore të pyjeve (rrallime dhe pastrime, hapje korridoresh për mbrojtjen nga zjarri, pyllëzime etj) sipas specifikimeve në tabelat e mëposhtme të masave silvikulturore në trungishte, cungishte dhe shkurre, të hartuara në zbatim të këtij plani.

9.2. Prerje vjetore silvikulturore

Në ndërhyrjet silvikulturore janë parashikuar të kryhen, rrallime duke hequr 20 - 30% të volumit të materialit drusor të ngastrës. Pastrimet do të kryhen në ato sipërfaqe të cungishteve ku nënpylli është shumë i dendur dhe bëhen pengesë për zhvillimin e drurëve të llojit lis, ndërhyrje të cilat do të riaktivizojnë ripërtëritjen dhe prodhimin e druve të zjarrit.

Pra, sasia e materialit drusor që mund të nxirret nga ndërhyrjet silvikulturore në zbatim të këtij plani menaxhimi do të jetë rreth 607.4 m³ e shtrirë në 10-të vite.

Grafiku i realizimit të ndërhyrjeve silvikulturore jepet në tabelën 9.3.2.1, po aty jepet numri i ngastrës, sipërfaqja, intensiteti i ndërhyrjes dhe vëllimi i materialit drusor që do të rezultojë.

Ndërhyrjet që propozohen	Ngastra pyjore 1a			
	Sipërfaqja dhe volumi		Intesiteti	
	Sip. ha	Volumi, m ³	%	Volumi, m ³
Rrallim II	20	1500	15	225
Hapje korridoresh për mbrojtje nga zjarri	0.5			37.5
Totali		1500		262.5
Ndërhyrjet që propozohen	Ngastra pyjore 1b			
	Sipërfaqja dhe volumi		Intesiteti	
	Sip. ha	Volumi, m ³	%	Volumi, m ³
Pastrim i nënpyllit	6	120	10	12
Hapje korridoresh për mbrojtje nga zjarri	0.6		100	12
Totali				24
Ndërhyrjet që propozohen	Ngastra pyjore 2b			
	Sipërfaqja dhe volumi		Intesiteti	
	Sip. ha	Volumi, m ³	%	Volumi m ³
Hapje korridoresh për mbrojtje nga zjarri	4	360	10	36
Totali				38

Ndërhjert që propozohen	Ngastra pyjore 6a			
	Sipeëfaqja dhe volumi		Intesiteti	
	Sip. ha	Volumi, m ³	%	Volumi m3
Ricungim lisi	34.5	690	15	103.5
Pastrimi i nënpyllit	34.5		10	69
Pyllëzime	4			
Totali				172.5
Ndërhjert që propozohen	Ngastra pyjore 6 b			
	Sipërfaqja dhe volumi		Intesiteti	
	Sip. ha	Volumi, m ³	%	Volumi m3
Pastrim i sipërfaqes	3.6	36		36
Pyllëzime	3.6			
Totali				36
Ndërhjert që propozohen	Ngastra pyjore 7			
	Sipeëfaqja dhe volumi		Intesiteti	
	Sip. ha	Volumi, m ³	%	Volumi m3
Ricungim lisi	19.6	392	20	78.4
Pyllëzime	8			
Totali				
Ndërhjert që propozohen	Ngastra pyjore 8			
	Sipërfaqja dhe volumi		Intesiteti	
	Sip. ha	Volumi, m ³	%	Volumi m3
Pastrim i sipërfaqes	1.1	22	100	22
Pyllëzime	1.1			
Totali				

Në urgjencën e parë do të jenë hapja e koridorreve, rrugëve të kalimit si dhe pastrimet e shkurreve dhe ferrave. Pyllëzimet, rralimet, ricungimet dhe prerje silvikulturore (pastrime) janë në urgjencën e dytë.

9.3. Planifikimi vjetor i masave

Në këtë plan mbarështimi janë përcaktuar me detaje masat silvikulturore që do ndërmerren në 10-të vitet në vijim për parcelat pyjore. Ato janë në përputhje të plotë dhe në harmoni me gjendjen aktuale të grumbullit si dhe do të synojnë çuarjen e grumbujve drejt vijimësisë dhe qëndrueshmërisë.

Struktura e pyjeve, duhet të ushtrojë kontroll periodik mbi të gjitha ndërhyrjet e planifikuara në këto ngastra.

Bashkia është përgjegjëse për të kontrolluar në detaje të imtësishme të gjitha ndërhyrjet e propozuara, dhe për të shoqëruar të gjitha proceset.

Nëse masat silvikultura të propozuara do të ndiqen me rigorizitet, atëherë aspektet e menaxhimit të qëndrueshëm dhe vijimësia e grumbullit do të jenë të garantuara

Planifikimi i ndërhyrjeve për vitet 2026-2036

Tab.9.3.1.1

Parcelat	Metoda e trajtimit silvikulturor	Sip.që do ndërhyhet Ha	Kurorë dendësia	Intensiteti %	Volumi materialit (m³)
1a, 1b,2b	Hapje korridoresh për mbrojtjen nga zjarri	5.1	0.6		
1a	Rrallime II	20	0.9	15	225
1b,6a	Pastrim nënpylli	40.5	0.7		81
8,6b	Shfrytëzim shkurresh	4.7			58
6a,6b,7,8	Pyllëzime	16.7			
		87			364

E ndarë sipas viteve jepen në tabelën e mëposhtme

Tab.9.3.1.2

Viti	KODI	Metoda e trajtimit silvikulturor	Volumi i Parcelave m3	Sip.që do ndërhyhet Ha	Kurorë dendësia	Intensiteti %	Volumi materialit (m³)
2027	FR27 00 01a	Hapje korridoresh për mbrojtje nga zjarri	1500	0.5	0.9		37.5
	FR27 00 01b	Hapje korridoresh për mbrojtje nga zjarri	120	0.6	0.7		12
	FR27 00 02b	Hapje korridoresh për mbrojtje nga zjarri	360	0.5	0.9		45
Totali 2027							94.5
2028	FR27 00 01b	Pastrim nën pylli	120	6	0.7		12
	FR27 00 01a	Rrallime II	1500	20	0.9		225
Totali 2028							237
2029	FR27 00 06a	Ricungimi lisi	690	20	0.8	15	60
	FR27 00 06a	Pastrim nënpylli	690	10	0.8	10	69
	FR27 00 06b	Shfrytëzim shkurresh	36	3.6	0.3	100	36

Totali 2029							165
2030	FR27 00 06a	Ricungim lisi	690	14.5	0.7	15	43.5
	FR27 00 06a	Pastrim nënpylli	690	10	0.8	10	69
Totali 2030							112.5
2031	FR27 00 06a	Pyllëzime	690	4	0	0	0
Totali 2031							0
2032	FR27 00 06b	Pyllezime	0	3.6	0	0	0
	FR27 00 06a	Sherbime, zëvendësime	0	3.6	0	0	0
Totali 2032							268.75
2033	FR27 00 06b	Shërbime, zëvendësime	0	3.6	0	0	0
	FR27 00 007	Ricungim lisi	392	11.6	0.8	20	78.4
Totali 2033							2.2
2034	FR27 00 06b	Shfrytëzim shkurresh	22	1.1	0.3	100	22
	FR27 00 007	Pyllëzim	0	8	0	0	0
Totali 2034							22
2035	FR27 00 007	Shërbime, zëvendësime	0	8	0	0	0
	FR27 00 008	Pyllëzime	0	1.1	0	0	0
Totali 2035							0
2036	FR27 00 008	Shërbime, zëvendësime	0	1.1	0	0	0
Totali 2036							0
2037	FR27 00 007	Shërbime, zëvendësime	0	8	0	0	0
Totali 2037							0

9.3.3 Masat në infrastrukture dhe në zonat e degraduara, rekreacionale dhe didaktike.

Përsa i përket masave në infrastrukturë nuk mendojmë se ka shumë pasi grupngastrat objekt i këtij plani mbarështimi janë të përshkuara nga rrugë auto verore dhe rrugë automobilistike të cilat janë në gjendje të mirë.

9.4. Masat afatgjata

Masa afatgjata do të konsiderohen të gjithë ato masa të planifikuara në objektivat e këtij plani mbarështimi të cilat zgjasin më shumë se afati kohor i vlefshmërisë së këtij plani. Të tilla masa do të konsiderojmë kryesisht objektivat e planifikuara për zbatimin e pyllëzimeve ku si fillim do ta nisim me ngastrën 6/a, b dhe 8 dhe më pas do të vazhdohet me ndërhyrjet e tjera në ngastrat e tjera në vazhdimësi.

9.4.1. Masat silvikulturale në trungishte

Disa nga masat silvikulturore të parashikuara ku do të fokusohemi për të zbatuar gjatë periudhës së vlefshmërisë së planit të mbarështimit:

- Hapjen e korridoreve për mbrojtjen nga zjarri, kjo duke qënë një sipërfaqe pyjore e cila kurorë dëndësinë në përgjithësi e ka 0.9.
- **trajtime silvikulturore:** Këto masa do të aplikohen në parcelat pyjore bazuar në vrojtimin e kryer në terren. Planifikimi i trajtimeve silvikulturore që do të kryhet në parcelat pyjore janë rrallimet e tipit të II, pastrimet e nënpyllit etj.

9.4.2. Masat silvikulturore në cungishte

Masat silvikulturore që do të përdoren në cungishte do të jenë ricungimet e lisit dhe pastrimin e nënpyllit pasi ëshë shumë i dendur edhe në këto ngastra.

Atje ku cungishtet janë të degraduara do të ndërhyjmë me pastrimin e sipërfaqes dhe pyllëzime artificiale me lloje autokton.

9.4.3. Masat silvikulturore në shkurre

Shkurret, masat silvikulturore që do të përdoret këtu do të jetë shfrytëzimi i tyre pasi ato janë shkurre të degraduara dhe më pas do të ndërhyjmë me pyllëzime duke zgjedhur llojet autoktone.

9.4.4 Gjendja dhe masat në infrastrukturën

Grupngastrat konsiderohen si një sipërfaqe e fondit pyjor e cila është e pasur me rrugë dhe shtigje kalimi ndaj është parashikuar të hapen rrugë dhe shtigje për mbrojtjen nga zjarri, ku parcela do të ndahet në breza për të lehtësuar punën dhe lëvizjen pa pengesa të zjarrfikësve dhe njerzve në rast zjarri, aksidenti si dhe do ndihmonte në realizimin e qëllimit të privatit për zhvillim të agroturizmit dhe ekoturizmit në vijim.

10. VLERËSIMI EKONOMIK

10.1. Vlerësimi i efekteve të masave të planifikuara në pyje

Punimet e mirëmbajtjes së infrastrukturës rrugore aktuale, hapjes e vënies në funksion të një infrastrukture të përshtatshme që do i shërbente ekonomisë në shumë aspekte, padyshim që kane kosto. Gjithashtu punimet silvo-kulturale të planifikuar kërkojnë vlera paraprake të konsiderueshme financiare për t'u realizuar.

Për këtë qëllim në këtë kapitull do të flasim pikërisht për kostot dhe përfitimet ekonomike nga aplikimi dhe zbatimi i objektivave të parashikuara në këtë projekt menaxhimi.

Diferenca ndërmjet përfitimeve dhe kostove të parashikuara do të ishte një bilanc i objektivave ekonomike të planifikuara të para dhe në këndveshtrimin e përfitimeve sociale.

10.2. Planifikimi i të ardhurave/përfitimeve

Në ngastrat pyjore, objekt i këtij plani mbarështimi do të kryhen aktivitetet e parashikuara të cilat sigurojnë të ardhura direkte dhe indirekte.

Të ardhurat kryesisht do të sigurohen nga dhënit në përdorim sipas aktiviteteve të përcaktuara në ligjin nr. 57/2020 “Për Pyjet“ dhënia me qira për kullotje, etj.

Llogaritja e të ardhurave është kryer duke ju referuar tarifave të përcaktuara me VKM-në nr.559 datë 29.07.2022.

Nga realizimi i ndërhyrjeve të planifikuara në këtë plan mbarështimi, parashikohet që të prodhohet një volum materiali drusor prej rreth 607 m³, një total i cili do të përdoret nga Bashkia për furnizimin e enteve shtetërore me dru zjarri.

10.3. Planifikimi i kostove/shpenzimeve

Përsa i përket kostos së punimeve mund të themi se punimet si pyllezime, pastrimi i nënpyllit, mund të jenë zërat që do të kenë një kosto të konsiderueshme ndërkohë që për punimet si shfrytëzimi i shkurreve, ricungimi i lisit etj, Bashkia mund të ngrejë një njësi me punëtorë të kualifikuar të cilët nën drejtimin e specialistëve të pyjeve do të realizojnë punimet.

Zeri “ hapja e korridoreve për mbrojtjen nga zjarri “ përfshin pastrimin e gjithë rrugëve egzistuese dhe hapjen e një korridori të ri.

10.4. Analiza kosto-përfitim

Përfitimet nga kryerja dhe realizimi i objektivave të planifikuara në këtë plan mbarështimi, konsiderohen të kënaqshme si në aspektet sociale ashtu dhe në ato mjedisore, ndërsa një numër i konsiderueshëm i banorëve të zonës pritet të punësohet duke ndikuar në reduktimin e papunësisë dhe në zbutjen e efekteve sociale në këto zona.

Duke i bërë një analize të shkurtër rezultojnë se shpenzimet kanë një vlerë pak më të lartë se sa të ardhura.

Megjithatë në mënyrë indirekte mendojmë se këto shpenzime do të kenë një ndikim shumë pozitiv duke e shndërruar zonën një atraksion turistik më tërheqës dhe më të aksesueshëm jo vetëm për turistët por edhe për grupet e studimeve shkencore etj.

11. LIDHJA MIDIS PLANIT TË MBARËSHTIMIT TË PYJEVE E KULLOTAVE DHE SISP

Baza e të dhënave që ka shërbyer për hedhjen dhe përpunimin e informacionit, i cili do të jetë bashkëlidhur këtij plani mbarështimi dhe do të mundësojë në të ardhmen, lidhjen e planit të mbarështimit me Sistemin e Informacionit Kombëtar për Pyjet.

Aktualisht SISP, nuk është vënë në funksion dhe bartja e planit mbi këtë sistem është e pamundur.

12. PROCESI I VALIDIMIT TË PMPK NË SISP

Pas hartimit të Planit të Mbarështimit konsulenti duhet të paraqesë PMP për miratim dhe pranim. Miratimi i planit të ri të mbarështimit dhe futja në SISP konsiston në këto procese :

- korigjimi i të dhënave gjeo-hapsinore
- plotësimi dhe korigjimi i informacionit të përgjithshëm të attributeve.

13. MIRATIMI I PLANIT TË MBARËSHTIMIT TË PYJEVE

Kërkesat bazë për miratimin e planit të mbarështimit janë:

Pas hartimit të planit të mbarështimit, një përmbledhje ekzekutive do të përgatitet duke nxjerrë në pah karakteristikat e tij si: objektivat e planit, treguesit e fondit pyjor dhe kullosor, mundësinë vjetore të shfrytëzimit, ndërhyrjet silvikulturore dhe efektiviteti ekonomik i zbatimit të planit të mbarështimit si dhe pjesëmarrja e komunitetit lokal në hartimin e tij.

Pas kalimit në Këshillin Bashkiak plani i Mbarështimit të ekonomisë Pyjore “Vajkan Libofshë “ do të dërgohet për miratim në Ministrinë e Mjedisit.

14. MONITORIMI I ZBATIMIT TË PMP

SISP bën të mundur monitorimin vjetor të ndërhyrjeve që kryhen në përputhje me planin e mbarështimit si dhe rastet e ngjarjeve ekstreme si psh: zjarret në pyje, erozioni etj, që ndikojnë në gjendjen e territorit dhe menaxhimin e planit. Monitorimi i zbatimit të PMP do të bëhet sipas procedurës së pritshme të futjes së informacionit në SISP.

15. RISHIKIMI PERIODIK I ZBATIMIT TË PLANIT TË MBARËSHTIMIT

Megjithëse progresi në zbatimin e aktiviteteve specifike është një nga problemet kyç në rastin e një plani mbarështimi, ky i fundit duhet të rishikohet në mënyrë të rregullt çdo vit si pjesë e procesit të ruajtjes dhe kontrollit mbi qeverisjen e pyjeve.

16. RISHIKIMI AFAT-MESËM I PLANIT TË MBARËSHTIMIT

Rishikimi i planit të mbarështimit ka për qëllim adaptimin me kushtet e reja, të krijuara gjatë zbatimit të tij. Për këtë arsye hartimi i planit të ri të mbarështimit, përfaqëson një rishikim të situatës në ekonominë pyjore, për të cilën ai hartohet.

Rishikimi në fund të periudhës 10-të vjeçare përmban një analizë të rezultateve të kësaj periudhe, pas zbatimit të planit të mbarështimit, që lidhen me:

- evidentimin dhe pasqyrimin e ndryshimeve përsa i përket përhapjes së vegjetacionit pyjor brenda dhe jashtë ngastrave, pra korigjimeve të nevojshme nëse vërehen ndryshime kufijsh.
- evidentimin dhe pasqyrimin e ndryshimeve strukturore dhe fazave të zhvillimit të grumbujve.
- evidentimin dhe pasqyrimin e gjendjes fitosanitare të grumbujve.

- evidentimin dhe pasqyrimin e infrastrukturës rrugore të shtuar për caktimin e objektivave të rinj, për periudhën pasardhëse.

17. RISHIKIMI FINAL I PLANIT TË MBARËSHTIMIT

Monitorimi i aktiviteteve të parashikuara për t'u aplikuar në një periudhë kohore nga 4-7 vjet do të konsiderohen si indikatorë afatmesëm. Në këtë grup indikatorësh përfshihen si monitorimi i aktiviteteve të lidhura me ndërhyrjet në grumbujt pyjor, por edhe ndjekja e realizimit të punimeve të tjera të planifikuara.

18. PËRGATITJA E HARTAVE HYRJE

Në lidhje me rëndësinë që kanë hartat në procesin e planifikimit është e nevojshme që të përcaktohen:

- tematika e hartave në përshtatje me kushtet e reja të përdorimit të territorit;
- elementet grafike standart, ngjyrat dhe emërtesat;

Dixhitalizimi i hartave dhe integrimi i tyre në sistemin GIS SISP menaxhon direkt hartat dhe elementët e dhënë më poshtë (vijat, ngjyrat, emërtimet etj) mund të jenë standart i sistemit të informacionit për përgatitjen e hartave.

Përpara se sistemi të jetë operacional, përgatitja e hartave duhet të realizohet në sistemin GIS duke respektuar standartet e mëposhtme.

Hartat mund të ndërtohen nëpërmjet GIS duke përdorur sistemin e ri zyrtar KRGJSH 2010 kompatibël me sistemin koordinativ UTM. Hartat mund të ndërtohen në shkallët 1:25 000 ose 1:10 000 në rastin kur sipërfaqja është e vogël. Hartat dhe ortofotot që janë të disponueshme në faqen e ASIG (ëëë.asig.gov.al) mund të përdoren direkt edhe nga SISP.

Hartat më të rëndësishme për planin e mbarështimit

- Harta e ngastrës pyjore pronë private
- Harta e rrjetit rrugor, infrastrukturës dhe zonave të degraduara
- Harta e ndërhyjeve që do të kryhen

ANEKSET:

Aneksi 1 Skedat e përshkrimit parcelar

Aneksi 2 Foto të objektit ku do të kryhen ndërhyrjet

Aneksi 3 Hartat